



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.504/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga [REDACTED], nga Komuna e Vushtrrisë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ-KKZ, me seli në Vushtri për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, , në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë e palejuar ankesa Anr.504/2025 e datës 10.02.2025, parashtruar nga [REDACTED], nga Komuna e Vushtrrisë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ-KKZ, me seli në Vushtri për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 10.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë përmes postës, nga [REDACTED], Komuna e Vushtrrisë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ-KKZ, me seli në Vushtri, në të cilën theksohet se Zyra e KQZ-së në Komunën e Vushtrrisë në krye me [REDACTED] ka bërë shkelje të Ligjit me transportin e materialit zgjedhor ku i ka zgjedhur kombibusat të cilët kanë tenderë për bartjen e nxënësve të shkollave. Kurse ne që kemi punuar rregullisht edhe i kemi pas punët pak me ligisht, nuk na ka marrë të punojmë, në këtë kategori përfshihen Familjet e dëshmoreve, invalidëve dhe ndonjë familjar i veteranëve të gjithëve na kanë refuzuar, ku [REDACTED] punon me të njofshum. Andaj ju kisha lutë komisionit ta merrni parasysh kërkesën time.

Në përgjigjen në ankesë nga KQZ me datë 11.02.2025 theksohet se për përgjigje në ankesë të parashtruar nga [REDACTED] fshatí Akrashticë, Komuna e Vushtrrisë, lidhur me ndarjen kombibusëve nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Vushtrrisë, për transportimin e materialit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 9 shkurt 2025. Bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, gjegjësisht neni 119 i LZP-së përcakton se: PZAP-i

vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj, në nenet 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe nenit 105.1. Nga interpretimi i dispozitave ligjore Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nuk parashihet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen vendimet e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) të kësaj natyre të KQZ-së, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, vëren se e njëjta:

Ankesa është e pa lejuar.

Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës, paneli iu referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 3, me të cilin është përcaktuar se *“PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.”* Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesë është specifikuar me nenet, 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1, si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9, të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave.

Sipas vlerësimit të Panelit, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen vendimet e kësaj natyre të KQZ-së, përkatësisht, vendimi i KQZ-së lidhur me ndarjen kombibusëve nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Vushtrrisë, për transportimin e materialit zgjedhor, në këtë kuptim, paneli vlerëson se rasti lëndor nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura si më lart, në pajtim me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, si dhe nenit 119 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejueshme.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A.nr.504/2025, datë 12.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LJP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.